



@matura.shteterore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 519/Prot.
/4

Tiranë, më 01/07/2020

V E N D I M

Nr 13, datë 01.07.2020

P Ë R

**NDRYSHIM NË KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË FAKULTETIT TË
ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS,
PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 9, Rregulloren e UPT "Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në UPT", si dhe në Vendimin Nr. 20, datë 08.06.2020 të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës "Mbi heqjen e testit të pranimit në programet e studimit Master i shkencave në Arkitekturë, Profili Arkitekt, Master i shkencave në Arkitekturë, Profili Urbanist, si dhe në programin e studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn për vitin akademik 2020-2021", Senati akademik në mbledhjen e datës 01.07.2020,

VENDOSI:

1. Të hiqet testi, si kriter pranimi për vitin akademik 2020-2021, në programet e studimit:


- Program i integruar i studimit Master i shkencave në Arkitekturë Profili Arkitekt,
- Program i integruar i studimit Master i shkencave në Arkitekturë Profili Urbanist,
- Program i studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn.

2. Kriteret e pranimit në këto programe, për vitin akademik 2020-2021, të jenë si më poshtë:

- Kandidatët duhet të kenë mesataren e shkollës së mesme në përputhje me kriteret e vendosura në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.436, datë 03.06.2020 "Për

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



@matura.shteterore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim".

- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{(\text{VKM})} + 0.3(0.5 * \text{Mes}_{(\text{Matematike})} + 0.4 * \text{Mes}_{(\text{Fizike})} + 0.1 * \text{Mes}_{(\text{Kimi})}) * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

- **Mes_(VKM)**, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2020 – 2021, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;
- **Mes_(Matematike)**, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;
- **Mes_(Fizike)**, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **Mes_(Kimi)**, nota mesatare e thjeshtë e kimit në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **K_{koef. Shkollës}**, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2020 – 2021, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2020 – 2021.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Ngarkohet Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës për zbatim të këtij Vendimi



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914.